

1034
30.07.2019



- Administrata e
- Sekretari i përgjithshëm
- Drejtori i përgjithshëm

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

30.07.2019

**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE DHE PËRPUTHSHMËRISË PËR
ARSIMIN, SPORTIN DHE RININË
DREJTORIA E DERREGULLIMIT, LEJEVE, LICENCAVE DHE MONITORIMIT**

Nr. 7528/Prot.

Tiranë, më 26.7. 2019

Lënda: Dërgohet raporti i grupit të punës mbi verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara për vitin akademik 2019-2020.

Drejtuar:

UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTËR

Për dijeni:

**FAKULTETIT TË SHKENCAVE SHOQËRORE
FAKULTETIT TË SHKENCAVE NATYRORE
FAKULTETIT EKONOMIK**


Gjirokastrë

Lutem gjeni bashkëlidhur raportin e grupit të punës të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, mbi verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, për kuotat e deklaruara nga ana juaj për vitin akademik 2019-2020.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Olton MUZAKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 752P Prot.

Tiranë, më 26.7. 2019

Lënda: Raport mbi verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara nga Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, për vitin akademik 2019 – 2020.

Z. OLTJON MUZAKA
Sekretar i Përgjithshëm, MASR

Tiranë

Mbështetur në Urdhrin Nr. 260, datë 03.05.2019, të Sekretarit të Përgjithshëm të MASR për "Ngritjen e grupit të punës për verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara nga institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2019-2020", grupi i punës kreu verifikimet pranë Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, sipas objektit dhe metodologjisë si më poshtë:

OBJEKTI

Verifikimi i kapaciteteve pritëse akademike dhe infrastrukturore për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara.

METODOLOGJIA

- Takim me drejtues të Universitetit "Eqrem Çabej";
- Verifikimi i kapaciteteve infrastrukturore;
- Shqyrtimi i dokumentacionit të stafit akademik.

GRUPI I PUNËS

- a) Rozeta Hoxha
- b) Denisa Shehaj



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 23, AL 1001, Tiranë
Tel: +355 4 42230244 Fax : +355 4 42230244

Email: info@arsimi.gov.al
Web site: www.arsimi.gov.al

GJETJE DHE KONSTATIME

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë është institucion publik i arsimit të lartë dhe përbëhet nga 3 Njësi Kryesore si më poshtë:

1. Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore i cili përbëhet nga 6 njësi bazë, ofron 24 programe studimi nga të cilët 8 BSc, 3 MP, 3 MSc, 8 "Master", 2 programe studimi me karakter profesional dhe 1 program doktoratë.
2. Fakulteti i Shkencave të Natyrës i cili përbëhet nga 3 njësi bazë, ofron 8 programe studimi nga të cilët 7 BSc, 1 MP.
3. Fakulteti i Ekonomik i cili përbëhet nga 3 njësi bazë dhe ofron 9 programe studimi, nga të cilët 3 BSc, 3 MP dhe 3 programe studimi me karakter profesional.

I- KAPACITETET AKADEMIKE TË INSTITUCIONIT

Për vitin akademik 2019-2020, Institucioni ka deklaruar kapacitete akademike për secilin Departament sipas Fakulteteve, si më poshtë:

Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, ka në strukturën e tij gjithsej 85 pedagogë, nga të cilët 59 personel akademik me kohë të plotë, 26 personel akademik me kohë të pjesshme të shpërndarë në 76 departamente. Raporti staf efektiv/joefektiv është në bazë fakulteti 69% me 31%.

- Departamenti i Historisë dhe Gjeografisë¹, ka në strukturën e tij 22 pedagogë nga të cilët 13 personel akademik me kohë të plotë, të gjithë me grada/tituj, 9 personel akademik me kohë të pjesshme, 7 me tituj dhe grada. Raporti staf efektiv/joefektiv është 59% me 41%.
- Departamenti i Gjuhës Shqipe, ka në strukturën e tij 7 pedagogë personel akademik me kohë të plotë, nga të cilët 5 me grada/tituj akademik. 100% e personelit është efektiv.
- Departamenti i Letërsisë ka në strukturën e tij 8 pedagogë nga të cilët 7 personel akademik me kohë të plotë, 4 me grada dhe tituj dhe 1 personelit akademik i ftuar, Prof. Dr. Raporti staf efektiv/joefektiv është 87% me 13%.
- Departamenti i Gjuhës Letërsisë dhe Qytetërimit Grek ka në strukturën e tij 10 pedagogë nga të cilët 8 personel akademik me kohë të plotë, 3 me grada dhe tituj dhe 2 personelit akademik me kohë të pjesshme. Raporti staf efektiv/joefektiv është 80% me 20%.
- Departamenti i Gjuhëve të Huaja ka në strukturën e tij 20 pedagogë nga të cilët 14 personel akademik me kohë të plotë, 5 me grada dhe tituj, 6 personel akademik me kohë të pjesshme. Raporti staf efektiv/joefektiv është 71% me 19%.
- Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies ka në strukturën e tij 18 pedagogë nga të cilët 10 personel akademik me kohë të plotë, 3 me grada/tituj dhe 10 personel akademik me kohë të pjesshme 1 Dr. Raporti staf efektiv/joefektiv është 55.5% me 44.5%.

Referuar numrit të studentëve të pritshëm 1113 (363 student vijues + 750 kuota të reja), si dhe numrit të stafit akademik me kohë të plotë, 59 pedagogë, raporti pedagog/student për Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore është 1 pedagog/19 studentë.

Fakulteti i Shkencave të Natyrës, ka në strukturën e tij gjithsej 71 pedagogë nga të cilët, 32 personel akademik me kohë të plotë dhe 39 personel akademik me kohë të pjesshme, të shpërndarë në 3 departamente. Raporti staf efektiv/joefektiv në bazë fakulteti është 44% / 56%.

¹ Ndryshuar pas observacioneve të dërguara nga IAL me shkresa 4815/86, datë 12.07.2019



- Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, ka në strukturën e tij 27 pedagogë nga të cilët 15 personel akademik me kohë të plotë, 8 me tituj/ grada dhe 12 personel akademik me kohë të pjesshme 3 me tituj/grada. Raporti staf efektiv/joefektiv është 55.5% me 44.5%.
- Departamenti i Biologji Kimisë, ka në strukturën e tij 12 pedagogë nga të cilët 9 personel akademik me kohë të plotë, 8 me grada dhe tituj, dhe 3 personel akademik me kohë të pjesshme 1 me tituj dhe grada. Raporti staf efektiv/joefektiv është 75% me 25%.
- Departamenti i Infermierisë ka në strukturën e tij 32 pedagogë nga të cilët 8 personel akademik me kohë të plotë, 3 me tituj dhe grada, dhe 24 personel akademik me kohë të pjesshme, 2 me tituj dhe grada. Raporti staf efektiv/joefektiv është 25% me 75%.

Referuar numrit të studentëve të pritshëm 663 (253 studentë vijues dhe 410 kuota të reja), si dhe numrit të stafit akademik me kohë të plotë, 32 pedagogë, raporti pedagog/student për Fakultetin e Shkencave të Natyrës është 1 pedagog/20 studentë.

Fakulteti i Ekonomisë, ka në strukturën e tij gjithsej 26 pedagoge nga të cilët 21 personel akademik me kohë të plotë dhe 5 personel akademik me kohë të pjesshme të shpërndarë në 3 departamente. Raporti staf efektiv/joefektiv në bazë fakulteti është 81% / 19%.

- Departamenti i Kontabilitet Financës, ka në strukturën e tij 8 pedagogë, nga të cilët 7 personel akademik me kohë të plotë, të gjithë me tituj dhe grada dhe 1 personel akademik me kohë të pjesshme. Raporti staf efektiv/joefektiv është 87% me 13%.
- Departamenti i Administrimit Publik ka në strukturën e tij 10 pedagogë, nga të cilët 7 personel akademik me kohë të plotë, 3 me tituj dhe grada dhe 3 personel akademik me kohë të pjesshme. Raporti staf efektiv/joefektiv është 40% me 60%.
- Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit, ka në strukturën e tij 8 pedagogë, nga të cilët 7 personel akademik me kohë të plotë, të gjithë me tituj dhe grada dhe 1 personel akademik me kohë të pjesshme. Raporti staf efektiv/joefektiv është 75% me 25%.

Referuar numrit të studentëve të pritshëm 661 (331 studentw vijues dhe 330 kuota tw reja), si dhe numrit të stafit akademik me kohë të plotë, 21 pedagogë, raporti pedagog/student për Fakultetin e Ekonomisë është 1 pedagog/31 studentë.

Sa më sipër "Eqrem Çabej" Gjirokastër plotëson kriteret të përcaktuara në Vendimin Këshillit të Ministrave Nr. 418, datë 10.05.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre", Aneksi 1/A. Standardi i raportit personel akademik me kohë të plotë / student, sipas fushave kryesore të studimit, është Shkencat natyrore 1/45, Shkenca sociale 1/45 Shkenca humane 1/45.

II- KAPACITETET FIZIKE INFRASTRUKTURE

Universiteti i "Eqrem Çabej" Gjirokastër ushtron aktivitetin në 3 godina universitare si dhe godina e ish-Shtëpisë Ushtarake si më poshtë:

1. Godina A
2. Godina B
3. Godina C
4. Godina e ish-Shtëpisë së Ushtarakëve.

Godina A është godinë me 4 kate në të cilën zhvillojnë mësimin sipas orareve të përcaktuara, Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe disa departamente të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 23, AL 1001, Tiranë
Tel: +355 4 42230244 Fax : +355 4 42230244

Email: info@arsimi.gov.al
Web site: www.arsimi.gov.al



Shoqërore. Ka me një sipërfaqe totale të shfrytëzueshme prej 3255.5 m². Në këtë godinë janë në dispozicion të aktivitetit akademik salla seminaresh, me kapacitet 798 vende, salla leksionesh me kapacitet 737 vende, 6 laboratorë, si dhe biblioteka me 800 tituj/8 vende leximi.

Godina B është një godinë me 4 kate, në të cilën zhvillon kryesisht mësimin Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, si dhe Fakulteti Ekonomik. Godina ka një infrastrukturë të plotësuar dhe janë të pajisura me sistem ngrohje ftohje me kondicioner. Klasat janë të pajisura me mobilie sipas kapaciteteve normale dhe me tabela inteligjente të cilat bëjnë të mundur zhvillimin normal të procesit mësimor. Në këtë godinë ka kapacitet 951 vende për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve si dhe biblioteka me 1000 tituj/25 vende leximi. Ka një sipërfaqe në total të shfrytëzueshme prej 1937 m².

Godina C është godinë 4 kate, me një sipërfaqe totale të shfrytëzueshme 729.6 m². Në këtë godinë ka kapacitet 145 vende për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve, 2 laboratorë si dhe biblioteka me 7800 tituj/32 vende leximi. Përveç 2 klasave të mësimi, ka dhe shumë ambiente çlodhëse për studentët si bibliotekë, mjedise për Këshillin Studentor, ambient argëtues studentor (bar kafe), mjedis ku zhvillohet mbledhja e Senatit dhe ambiente të tjera.

Godina e ish-Shtëpisë së Ushtrakëve është godinë me 4 kate me sipërfaqe 1574 m². Kjo godinë ka në dispozicion 12 salla seminare me kapacitet 376 vende, 5 salla leksioni me kapacitet 619 vende, si dhe biblioteka me kapacitet 28 vende.

Totali i sipërfaqes që IAL disponon në funksion të aktivitetit akademik është 7496.1 m².

Për godinat e mësipërme institucioni disponon leje higjieno-sanitare nr. 299 datë 24.05.2019 dhe është në proces të marrjes së aktin e mbrojtjes nga zjarri.

III- PARASHIKIMI PËR KAPACITETET PRITËSE PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020

Me vendim Senati Nr. 174 prot. datë 7.02.2019 Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër ka miratuar kuotat e pranimit në 18 programe studimi të ciklit të parë BSc, 8 programe studimi të ciklit të dytë "Master", 4 programe studimi të ciklit të dytë MSc, 6 programe studimi të ciklit të dytë të studimit MP dhe 5 programe studimi me karakter profesional. Për vitin akademik 2019-2020 numri i kuotave të miratuara nga Senati Akademik është 1490 studentë². Kuotat e deklaruara nga IAL janë si më poshtë:

- Kuota të reja për programet e studimit Bachelor	635
- Kuota të reja për programet e studimit Master Profesional	295
- Kuota të reja për programet e studimit Master i Shkencave	60
- Kuota të reja për programet e studimit "Master"	260
- Kuota të reja për programet me karakter profesional	240

IAL ka deklaruar 13 kuota në programet e studimit të ciklit të tretë të cilat nuk janë riorganizuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Për arsyen e mësipërme grupi i punës nuk merr konsideratë kuotat e deklaruara nga IAL në programet e studimit doktoratë.

Për vitin akademik 2019-2020 IAL deklaron 2447 studentë të pritshëm në dy ciklet e studimit (1490 kuota të reja + 957 studentë aktualë pa vitin e fundit). Referuar numrit të studentëve të pritshëm, kapaciteteve dhe infrastrukturës së godinave (7496.1 m²), fushave të programeve të

² Ndryshuar pas observacioneve të dërguara nga IAL, po aty



studimit, për vitin akademik 2019-2020, Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë ofron një normativë të pritshme mesatare prej 3.1 m²/student.

Për sa më sipër, Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë plotëson kriteret të përcaktuara në Vendimin Këshillit të Ministrave Nr. 418, datë 10.05.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre" Aneksi 1/C, normativat për sipërfaqe të shfrytëzueshme sipas fushave të studimit janë minimumi 2.5 m²/student për studentët që ndjekin programe studimi në fushën e shkencave humane/natyrore/bujqësore/arte.

Sa i takon normativave të përcaktuara për studentët që ndjekin programe studimi në fushat mjekësore/teknike/informatike e cila është 5m²/student, kjo normativë nuk plotësohet.

KONKLUZIONE

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë plotëson kërkesën ligjore të përcaktuar në pikën 4 të nenit 25 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" ku cilësohet "Departamenti ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademik".

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë plotëson kriteret të përcaktuara në Vendimin Këshillit të Ministrave Nr. 418, datë 10.05.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre", Aneksi 1/A. Standardi i raportit personel akademik me kohë të plotë / student, sipas fushave kryesore të studimit, është shkencat natyrore /sociale/humane 1/45.

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë plotëson kriteret të përcaktuara në Vendimin Këshillit të Ministrave Nr. 418, datë 10.05.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre" Aneksi 1/C, normativat për sipërfaqe të shfrytëzueshme sipas fushave të studimit janë minimumi 2.5 m²/student për studentët që ndjekin programe studimi në shkencat natyrore/humane/sociale etj.

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë nuk plotëson kriteret të përcaktuara në Vendimin Këshillit të Ministrave Nr. 418, datë 10.05.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre" Aneksi 1/C, normativat për sipërfaqe të shfrytëzueshme sipas fushave të studimit janë minimumi 5 m²/student për studentët që ndjekin programe studimi në shkencat mjekësore/teknike/inxhinierike/teknologjike etj.

GRUPI I PUNËS

Rozeta Hoxha

Denisa Shehaj

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 23, AL 1001, Tiranë
Tel: +355 4 42230244 Fax : +355 4 42230244

Email: info@arsimi.gov.al
Web site: www.arsimi.gov.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE DHE PËRPUTHSHMËRISË
PËR ARSIMIN, SPORTIN DHE RININË
DREJTORIA E DERREGULLIMIT, LEJEVE, LICENCAVE DHE MONITORIMIT

Nr. 4031/11 Prot.

Tiranë, më 28.7. 2020

Lënda: Dërgohet raporti i grupit të punës për verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara nga Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, për vitin akademik 2020 - 2021.

UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Adresa: Rruga "Studenti 30", Gjirokastrë

Gjirokastrë

Bashkëlidhur ju dërgojmë raportin e grupit të punës për verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara nga institucioni juaj, për vitin akademik 2020 - 2021.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Oltjon MUZAKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 4081 Prot.

Tiranë, më 28. 7. 2020

Lënda: Raport mbi verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara nga Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, për vitin akademik 2020 - 2021.

Z. OLTJON MUZAKA

Sekretar i Përgjithshëm, MASR

Tiranë

Mbështetur në Urdhrin Nr. 152, datë 02. 06. 2020, të Sekretarit të Përgjithshëm të MASR për "Ngritjen e grupit të punës për verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara nga institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë, për vitin akademik 2020-2021", grupi i punës kreu verifikimet pranë Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, sipas objektit dhe metodologjisë si më poshtë:

OBJEKTI

Verifikimi i kapaciteteve pritëse akademike dhe infrastrukturore për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara.

METODOLOGJIA

- Takim me drejtues të Universitetit "Eqrem Çabej";
- Verifikimi i kapaciteteve infrastrukturore;
- Shqyrtimi i dokumentacionit të stafit akademik.

GRUPI I PUNËS

- a) Bledar Biçoku 
- b) Brendi Hoxha
- c) Aldo Hazizaj 



GJETJE DHE KONSTATIME

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë është institucion publik i arsimit të lartë dhe përbëhet nga 3 Njësi Kryesore si më poshtë:

1. Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore i cili përbëhet nga 6 njësi bazë, ofron 27 programe studimi nga të cilët 8 BSc, 3 MP, 4 MSc, 8 "Master" në mësuesi, 3 programe studimi me karakter profesional.
2. Fakulteti i Shkencave të Natyrës i cili përbëhet nga 3 njësi bazë, ofron 8 programe studimi nga të cilët 7 BSc, 1 Msc.
3. Fakulteti Ekonomik i cili përbëhet nga 3 njësi bazë dhe ofron 9 programe studimi, nga të cilët 3 BSc, 3 MP dhe 3 programe studimi me karakter profesional.

1- KAPACITETET AKADEMIKE TË INSTITUCIONIT

Për vitin akademik 2020-2021, Institucioni ka deklaruar kapacitete akademike për secilin Departament sipas Fakulteteve, si më poshtë:

Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore përbëhet nga 6 departamente;

- Departamenti i Historisë dhe Gjeografisë, ka në strukturën e tij 20 pedagogë nga të cilët 8 personel akademik me kohë të plotë, të gjithë me grada/tituj, 12 personel akademik me kohë të pjesshme, 7 me tituj dhe grada. Raporti staf efektiv/joefektiv është 40% me 60%.
- Departamenti i Gjuhës Shqipe, ka në strukturën e tij 7 pedagogë, nga të cilët 6 personel akademik me kohë të plotë, 4 me grada/tituj akademik dhe 1 personel akademik me kohë të pjesshme, me gradën shkencore Dr.
- Departamenti i Letërsisë ka në strukturën e tij 8 pedagogë nga të cilët 7 personel akademik me kohë të plotë, 4 me grada dhe tituj dhe 1 personel akademik i ftuar, Prof. Dr. Raporti staf efektiv/joefektiv është 87% me 13%.
- Departamenti i Gjuhës Letërsisë dhe Qytetërimit Grek ka në strukturën e tij 10 pedagogë nga të cilët 8 personel akademik me kohë të plotë, 3 me grada dhe tituj dhe 2 personel akademik me kohë të pjesshme. Raporti staf efektiv/joefektiv është 80% me 20%.
- Departamenti i Gjuhëve të Huaja ka në strukturën e tij 15 pedagogë nga të cilët 11 personel akademik me kohë të plotë, 5 me grada dhe tituj, 4 personel akademik me kohë të pjesshme, 1 Dr. Raporti staf efektiv/joefektiv është 73% me 17%.
- Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies ka në strukturën e tij 18 pedagogë nga të cilët 10 personel akademik me kohë të plotë, 3 me grada/tituj dhe 10 personel akademik me kohë të pjesshme 1 Dr. Raporti staf efektiv/joefektiv është 56% me 44%.

Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, ka në strukturën e tij gjithsej 78 pedagogë, nga të cilët 50 personel akademik me kohë të plotë, 28 personel akademik me kohë të pjesshme të shpërndarë në 6 departamente. Raporti staf efektiv/joefektiv është në bazë fakulteti 64% me 36%.

Për vitin akademik 2020-2021 në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore do të ndjekin studimet 1125 studentë (825 kuota të reja + 300 studentë aktuale pa vitin e fundit), 50 pedagogë me kohë të plotë. Nga sa më sipër raporti pedagog efektiv/student në nivel fakulteti është 1 pedagog për 23 studentë.



B/

[Signature]

Fakulteti i Shkencave të Natyrës, ka në strukturën e tij gjithsej 60 pedagogë nga të cilët, 26 personel akademik me kohë të plotë dhe 34 personel akademik me kohë të pjesshme, të shpërndarë në 3 departamente. Raporti staf efektiv/joefektiv në bazë fakulteti është 43% / 57%.

- Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, ka në strukturën e tij 20 pedagogë nga të cilët 11 personel akademik me kohë të plotë, 8 me tituj/ grada dhe 9 personel akademik me kohë të pjesshme 3 me tituj/grada. Raporti staf efektiv/joefektiv është 55% me 45%.
- Departamenti i Biologji Kimisë, ka në strukturën e tij 14 pedagogë nga të cilët 8 personel akademik me kohë të plotë, 7 me grada dhe tituj, dhe 6 personel akademik me kohë të pjesshme 2 me tituj dhe grada. Raporti staf efektiv/joefektiv është 57% me 43%.
- Departamenti i Infermierisë ka në strukturën e tij 26 pedagogë nga të cilët 7 personel akademik me kohë të plotë, 3 me tituj dhe grada, dhe 19 personel akademik me kohë të pjesshme, 1 me gradën shkencore Dr. Raporti staf efektiv/joefektiv është 27% me 73%.

Referuar numrit të studentëve të pritshëm 497 (260 kuota të reja + 237 studentë aktualë pa vitin e fundit), si dhe numrit të stafit akademik me kohë të plotë, 26 pedagogë, raporti pedagog/student për Fakultetin e Shkencave të Natyrës është 1 pedagog/19 studentë.

Fakulteti i Ekonomisë, ka në strukturën e tij gjithsej 33 pedagoge nga të cilët 17 personel akademik me kohë të plotë dhe 5 personel akademik me kohë të pjesshme të shpërndarë në 3 departamente. Raporti staf efektiv/joefektiv në bazë fakulteti është 51% / 49%.

- Departamenti i Kontabilitet Financës, ka në strukturën e tij 11 pedagogë, nga të cilët 7 personel akademik me kohë të plotë, të gjithë me tituj dhe grada dhe 4 personel akademik me kohë të pjesshme. Raporti staf efektiv/joefektiv është 64% me 36%.
- Departamenti i Administrimit Publik ka në strukturën e tij 12 pedagogë, nga të cilët 4 personel akademik me kohë të plotë, 3 me tituj dhe grada dhe 8 personel akademik me kohë të pjesshme. Raporti staf efektiv/joefektiv është 33% me 67%.
- Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit, ka në strukturën e tij 10 pedagogë, nga të cilët 6 personel akademik me kohë të plotë, 5 me tituj dhe grada dhe 4 personel akademik me kohë të pjesshme. Raporti staf efektiv/joefektiv është 60% me 40%.

Referuar numrit të studentëve të pritshëm 788 (415 kuota të reja + 373 studentë aktualë pa vitin e fundit), si dhe numrit të stafit akademik me kohë të plotë, 17 pedagogë, raporti pedagog/student për Fakultetin e Ekonomisë është 1 pedagog/46 studentë.

II- KAPACITETET FIZIKE INFRASTRUKTURE

Universiteti i "Eqrem Çabej" Gjirokastër ushtron aktivitetin në 3 godina universitare si dhe godina e ish-Shtëpisë Ushtarake si më poshtë:

1. Godina A
2. Godina B
3. Godina C
4. Godina e ish-Shtëpisë së Ushtarakëve.

Godina A është godinë me 4 kate në të cilën zhvillojnë mësimin sipas orareve të përcaktuara, Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe disa departamente të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore. Ka me një sipërfaqe totale të shfrytëzueshme prej 3255.5 m². Në këtë godinë janë në dispozicion të aktivitetit akademik salla seminaresh, me kapacitet 798 vende, salla konsionesh me



kapacitet 737 vende, 16 laboratorë, biblioteka me 800 tituj/8 vende leximi si dhe 16 boxe H/S për studentët.

Godina B është një godinë me 4 kate, në të cilën zhvillon kryesisht mësimin Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, si dhe Fakulteti Ekonomik. Godina ka një infrastrukturë të plotësuar dhe janë të pajisura me sistem ngrohje ftohje me kondicioner. Klasat janë të pajisura me mobilie sipas kapaciteteve normale dhe me tabela inteligjente të cilat bëjnë të mundur zhvillimin normal të procesit mësimor. Në këtë godinë ka kapacitet 951 vende për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve, biblioteka me 1000 tituj/25 vende leximi si dhe 16 boxe H/S për studentët. Ka një sipërfaqe në total të shfrytëzueshme prej 1937 m².

Godina C është godinë 4 kate, me një sipërfaqe totale të shfrytëzueshme 729.6 m². Në këtë godinë ka kapacitet 145 vende për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve, 2 laboratorë si dhe biblioteka me 7800 tituj/32 vende leximi. Përveç 2 klasave të mësimi, ka dhe shumë ambiente çlodhëse për studentët si bibliotekë, mjedise për Këshillin Studentor, ambient argëtues studentor (bar kafë), mjedis ku zhvillohet mbledhja e Senatit dhe ambiente të tjera.

Godina e ish-Shtëpisë së Ushtarakëve është godinë me 4 kate me sipërfaqe 1574 m². Kjo godinë ka në dispozicion 12 salla seminare me kapacitet 376 vende, 5 salla leksioni me kapacitet 619 vende, si dhe biblioteka me kapacitet 28 vende.

Totali i sipërfaqes që IAL disponon në funksion të aktivitetit akademik është 7496.1 m².

Për godinat e mësipërme institucioni disponon aktin e mbrojtjes nga zjarri nr.08, datë 30.01.2020. IAL deklaron se është në proces të marrjes së lejes higjieno-sanitare.

III- PARASHIKIMI PËR KAPACITETET PRITËSE PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020
Me vendim Senati Nr. 04 prot., datë 09. 01. 2020 Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë ka miratuar kuotat e pranimit në 18 programe studimi të ciklit të parë BSc, 8 programe studimi të ciklit të dytë "Master" në mësuesi, 5 programe studimi të ciklit të dytë MSc, 6 programe studimi të ciklit të dytë të studimit MP dhe 6 programe studimi me karakter profesional. Për vitin akademik 2019-2020 numri i kuotave të miratuara nga Senati Akademik është 1500 studentë. Kuotat e deklaruara nga IAL janë si më poshtë:

- Kuota të reja për programet e studimit Bachelor	610
- Kuota të reja për programet e studimit Master Profesional	307
- Kuota të reja për programet e studimit Master i Shkencave	75
- Kuota të reja për programet e studimit "Master" në mësuesi	248
- Kuota të reja për programet me karakter profesional	260

IAL ka deklaruar 13 kuota në programet e studimit të ciklit të tretë të cilat nuk janë riorganizuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Për arsyen e mësipërme grupi i punës nuk konsideratë kuotat e deklaruara nga IAL në programet e studimit doktoratë.



B/

A/

Për vitin akademik 2020-2021 IAL deklaroi 2410 studentë të pritshëm në dy ciklet e studimit (1500 kuota të reja + 910 studentë aktualë pa vitin e fundit). Referuar numrit të studentëve të pritshëm, kapaciteteve dhe infrastrukturës së godinave (7496.1 m²), fushave të programeve të studimit, për vitin akademik 2020-2021, Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë ofron një normativë të pritshme mesatare prej 3.1 m²/student, llogaritur në 2 fasha orare kjo normativë shkon në 6.2 m²/student.

Për sa më sipër, Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë plotëson kriteret të përcaktuara në Vendimin Këshillit të Ministrave Nr. 418, datë 10.05.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre" Aneksi I/C, normativat për sipërfaqe të shfrytëzueshme sipas fushave të studimit janë minimumi 2.5 m²/student për studentët që ndjekin programe studimi në fushën e shkencave humane/natyrore/bujqësore/arte dhe 5 m²/studentët që ndjekin programe studimi në fushën e shkencave mjekësore.

KONKLUZIONE

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë nuk plotëson kërkesën ligjore të përcaktuar në pikën 4 të nenit 25 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" ku cilësohet "Departamenti ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademik" për:

- Departamentin e Gjuhës Shqipe,
- Departamentin e Administrimit Publik,
- Departamentin e Politikave Ekonomike dhe Turizmit.

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë plotëson kriteret të përcaktuara në Vendimin Këshillit të Ministrave Nr. 418, datë 10.05.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre", Aneksi I/A.

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë plotëson kriteret të përcaktuara në Vendimin Këshillit të Ministrave Nr. 418, datë 10.05.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre" Aneksi I/C.

Në kuadër të situatës së Pandemisë Covid-19, institucioni i arsimit të lartë të jetë në gatishmëri dhe të marrë të gjitha masat paraprake për zbatimin e akteve ligjore e nënligjore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për kufizimin e përhapjes së Covid-19 për krijimin e distancës sociale për studentët dhe personelin dhe racionalizimin e kohës gjatë të cilës do të shfrytëzohet ambienti akademik.

GRUPI I PUNËS

Bledar Biçoku

Brendi Hoxha

Aldo Fazizaj

Adresa: "Rruga e Durrësit" Nr. 23, AL 1001, Tiranë

Email: info@arsimi.gov.al www.arsimi.gov.al

